

Nr. Prov. Nj-1
dt. 14. 12. 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, 14 / 12 / 2023

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

1/5 E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (JO MË PAK SE 28 DEPUTETË), me adresë komunikimi: Kuvendi i Shqipërisë, Blv. Dëshmorët e Kombit Nr. 4, Tiranë dhe e-mail: pd@rithemelimi.com

DREJTUAR:

GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SUBJEKTE TË INTERESUARA: KUVENDI I SHQIPËRISË, me adresë: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë;

GJYKATA E POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT (GJKKO), me adresë komunikimi: Rruga "Jordan Misja", 1000, Tiranë.

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT (SPAK), me adresë komunikimi: Rruga "Jordan Misja", 1000, Tiranë.

OBJEKTI:

1. Interpretimin përfundimtar të Nenit 73, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
2. Zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit dhe SPAK e GJKKO për sa i takon çështjes së heqjes dhe/ose kufizimit të lirisë së Deputetit të Kuvendit

në çdo formë, pa kërkuar e pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit;

3. Konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare, të masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj Deputetit Sali BERISHA, të kërkuara nga SPAK e të vendosura nga GJKKO (me Vendimet nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Vendimi nr. 56, datë 21.11.2023 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar), pa kërkuar e pa marrë paraprakisht autorizimin e Kuvendit;

4. Pezullimin e masave shtrënguese të sigurimit personal ndaj Deputetit Sali BERISHA, derisa Gjykata Kushtetuese të shprehet me vendim përfundimtar lidhur me këtë çështje.

BAZA LIGJORE:

Nenet 4/1, 6, 7, 38, pika 2, Neni 73, pika 2, 124, 131 pika 1, germa “ç”, Neni 132, 134 pika 1 germa “c” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), Nenet 5 dhe 6 paragrafi i parë i saj;

Nenet 118, 119 e vijues të Rregullores së Kuvendit, i ndryshuar.

Nenet 288 e vijues të Kodit të Procedures Penale.

***E nderuar Zonja Kryetare e Gjykatës Kushtetuese,
Të nderuar anëtarë të Gjykatës Kushtetuese***

Ne kërkesit, me cilësinë e 1/5 të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, po Ju parashtrojmë në vijim faktet, provat dhe argumentat ligjore, se përse kemi paraqitur këtë kërkesë, e cila në thelb synon të zgjidhë konfliktin e kompetenca ndërmjet institucionit të Kuvendit nga njëra anë dhe pushtetit gjyqësor nga ana tjetër, për sa i përket heqjes dhe/ose kufizimit të lirisë ndaj një Deputeti, në të gjitha format, kur këto kufizime të lirisë kryhen nga pushteti gjyqësor pa pyetur, pa kërkuar e pa marrë paraprakisht autorizimin e shprehur të Kuvendit.

Nisur nga sa do të argumentojmë në vijim, ne kërkesit i kërkojmë gjithashtu Gjykatës Kushtetuese interpretimin përfundimtar të Neni 73, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që konflikte të ngjashme të mos përsëriten në të ardhmen.